



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN  
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net

Ref. nr. 01/1903 Gjilan, më 04/10 /2019

Në bazë të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ të Masht-it, nr.17/2014 dhe nenit 2 të Udhëzimit Administrativ të Masht-it për kategoritë e studentëve për asistencë si dhe kushtet për fitimin e asistencës, nr.24/2012, si dhe nenit 31 të Ligjit nr. 4/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan shpall

## K O N K U R S

### **Për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan për vitin akademik 2019/2020**

Të drejtë lirimi nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2019/2020 kanë Studentët e Universitetit „Kadri Zeka” (shtetas të Republikës së Kosovës):

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
2. Studentët të cilët janë invalidë dhe veteran të luftës ose janë fëmijë të veteranëve apo invalidëve të luftës ;
3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Dy e më shumë studentë të të njëjtës familje të cilët studiojnë në universitetet publike ( studenti i dytë lirohet nga pagesa)

### **Për t'u liruar nga pagesa studentët paraqesin:**

#### **1. Për kategorinë e studentëve që janë në asistencë sociale nevojitet ose studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave:**

- 1.1 Vërtetimi nga Qendra për Punës Sociale, me të cilin vërtetohet se familja e studentit është përfituese e ndihmave sociale .
- 1.2 Vërtetimin nga Enti për punësim me të cilin vërtetohet se asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk janë në marrëdhënie pune si dhe vërtetimin nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa të Kuvendit Komunal me të cilin dëshmohet se asnjëri nga anëtarët e familjes së ngusht nuk ngarkohet me tatim nga të ardhurat katastrale apo se nuk ushtrojnë veprimtari biznesi
- 1.3 Vërtetimi nga fakulteti

**2. Për studentët të cilët janë invalid dhe veteran të luftës nevojitet:**

- Certifikata e mjekut specialist dhe
- Vërtetimi nga shoqata e invalidëve dhe veteranëve të luftës
- Vërtetimi nga fakulteti

**3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës;**

- Certifikatën nga zyra e regjistrimit civil të Kuvendit Komunal si dëshmi për humbjen e prindit në luftë;
- Vërtetimin se nuk ushtron veprimtari biznesi pjesa tjetër e familjes dhe
- Certifikatën e lindjes së aplikuesit (studentit/es)
- Vërtetimi nga fakulteti

**4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;**

- Studentët me nevoja të veçanta për të përfituar asistencë sociale duhet të paraqesin certifikatën e mjekut specialist me të cilin dëshmohet aftësia e tij e kufizuar fizike.
- Vërtetimi nga fakulteti

**5. Dy e më shumë studentë të të njëjtës familje të cilët studiojnë në universitetet publike ( studentit i dytë lirohet nga pagesa)**

- Kopjen e fletëpagesës dhe kopjen e ID kartelës
- Vërtetimin që ka regjistruar semestrin në vitin akademik 2019/2020

**PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Të gjithë studentët të cilët aplikojnë për asistencë konform kushteve të parapara sipas UA të MASHT-it nr. 24/2012 dokumentet e kërkuar duhet t'i dorëzojnë në njësitë përkatëse akademike nga data **04.10.2019 deri më date 11.10.2019**

Lista e të liruarve nga pagesa do të shpallet në ueb faqen e universitetit [www. uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)